

RREGULLORE
PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KAMPIT VEROR
“KH SUMMER CAMP”
2025

Neni 1
STATUSI

Fondacioni “Art Land Albania” (në vijim “Art Land Albania”) organizon kampin veror me emrin “KH Summer Camp” me vendodhje në adresën: Valbona Valley National Park, “Tradita Hotel”, Valbonë, Tropojë (në vijim “KH Summer Camp”), ku ofrohet organizimi dhe realizimi i veprimtarive për argëtimin, edukimin jo formal, si dhe zhvillimin personal për fëmijët e moshës 9-17 vjeç (në vijim secilit prej tyre “fëmija” dhe bashkërisht “fëmijët”) gjatë periudhave kohore 7 (shtatë) ditore (në vijim “periudhat kohore”).

Neni 2
MISIONI

Misioni i KH Summer Camp është:

- (a) krijimi i një mjedisi të sigurtë, të kënaqshëm dhe mbështetës për fëmijët për të kërkuar, zbuluar, nxitur, mësuar, vlerësuar, zhvilluar dhe promovuar aftësitë e fëmijëve në fusha të ndryshme si arti, kultura edukimi, sporti etj.;
- (b) nxitja e respektit dhe e vlerësimit mes fëmijëve, përmes zhvillimit dhe forcimit të bashkëpunimit social mes fëmijëve;
- (c) promovimi i krijimtariisë së fëmijëve dhe i bashkëpunimit mes tyre nëpërmjet veprimtarive të ndryshme në KH Summer Camp;

Neni 3
QËLLIMI

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave, që duhet të ndiqen për organizimin dhe funksionimin e KH Summer Camp, është përcaktimi i parimeve, standardeve dhe normave, që mundësojnë sigurinë, mirëqënien dhe përvojën e përshtatshme për të gjithë fëmijët pjesëmarrës në KH Summer Camp, si dhe që rregullojnë sjelljen e fëmijëve, sjelljen dhe etikën e drejtuesve, trainerëve dhe anëtarëve të personelit të KH Summer Camp.

Neni 4
PJESËMARRJA NË KH SUMMER CAMP

1. Pjesëmarrja në KH Summer Camp rezervohet vetëm për fëmijën, që regjistrohet në KH Summer Camp në përputhje me procedurën e regjistrimit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, pas pagimit të tarifës së regjistrimit, plotësimit të formularit të regjistrimit prej prindit, ose prej kujdestarit ligjor të fëmijës, të cilët nënshkruajnë dhe kontratën me Art Land Albania dhe pagesës së shumës prej prindit/kujdestarit ligjor në përputhje me kontratën, që lidh me Art Land Albania. Regjistrimi i fëmijës është i vlefshëm vetëm pas dorëzimit në KH Summer Camp të dokumenteve të nevojshme, duke përfshirë edhe informacionin shëndetësor të detajuar mbi fëmijën në lidhje me ndonjë problem shëndetësor apo alergjik të fëmijës.
2. Regjistrimi i fëmijës në KH Summer Camp kryhet prej prindit/kujdestarit ligjor të fëmijës përmes aplikimit online në faqen elektronike <https://www.summercamp.al>. Ky rregull vlen njësoj edhe për fëmijët ish-pjesëmarrës në KH Summer Camp.

3. Regjistrimet e fëmijëve në KH Summer Camp përfundojnë në datën 25 Maj 2025. Çdo regjistrim në KH Summer Camp që kryhet pas datës 25 Maj 2025 do të tarifohet ekstra për prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës për arsye të mbingarkesës së departamenteve të Art Land Albania.
4. Nëse numri i përgjithshëm i fëmijëve të regjistruar në KH Summer Camp nuk arrin numrin minimal të përcaktuar nga Art Land Albania për të marrë pjesë në KH Summer Camp, atëherë Art Land Albania ka të drejtë që të mos zhvillojë KH Summer Camp, të çregjistrojë fëmijën nga KH Summer Camp, të njoftojë me shkrim prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës për zgjidhjen e kontratës dhe për çrregjistrimin e fëmijës. Art Land Albania do të kryejë rimbursimin e shumës që prindi/kujdestari ligjor ka paguar në bazë të kontratës së lidhur me Art Land Albania.
5. Fëmija duhet të lajmërojë menjëherë anëtarët e personelit të KH Summer Camp në rast plagosjeje, sëmundjeje ose ndonjë gjendjeje të pasigurt.

Neni 5

SIGURIA DHE PËRGJEGJËSIA

1. Drejtuesit, trainerët dhe anëtarët e personelit të KH Summer Camp emërohen nga Art Land Albania dhe mbikqyrin fëmijët në çdo kohë gjatë veprimtarive në KH Summer Camp dhe do të sigurojnë një ambient të sigurt për të gjithë fëmijët 24 orë në 24 orë.
2. Anëtarët e personelit të KH Summer Camp do të jenë të pranishëm gjatë aktiviteteve të KH Summer Camp për të siguruar që çdo situatë emergjente në lidhje me fëmijët të trajtohet me kujdes dhe në kohë.
3. Drejtuesit, trainerët dhe anëtarët e personelit të KH Summer Camp do të trajtojnë fëmijet me respekt dhe kujdes gjatë gjithë kohës së pjesëmarrjes së tyre në KH Summer Camp.
4. Çdo fëmijë duhet të jetë i pajisur me siguracionin e sigurimit të jetës dhe të sigurimit të shëndetit për periudhat kohore të pjesëmarrjes në KH Summer Camp dhe për territorin e Shqipërisë.
5. Art Land Albania nuk mban përgjegjësi për shpenzimet e trajtimeve mjekësore për fëmijët që nuk janë të pajisur me siguracionin e sigurimit shëndetësor.

Neni 6

ORGANIZIMI I KH SUMMER CAMP

1. Veprimtaritë argëtuese, edukuese, zhvilluese për fëmijët organizohen dhe realizohen në KH Summer Camp përmes programeve mësimore, edukuese dhe zhvilluese nën drejtimin e trainerëve të KH Summer Camp
2. Fëmijët duhet të respektojnë orarin dhe rregullat e caktuara të KH Summer Camp, përfshirë oraret e ngrënies, oraret e fjetjes dhe rregullat për higjienën.
3. Fëmijët duhet të jenë të pranishëm në të gjitha veprimtaritë argëtuese, edukuese, zhvilluese për fëmijët, që organizohen dhe realizohen në KH Summer Camp. Fëmijët pjesëmarrës në KH Summer Camp duhet të kenë kujdes për sigurinë e tyre dhe të tjerëve, duke shmangur veprimet e rrezikshme dhe duke ndjekur dhe zbatuar udhëzimet e drejtuesve, trainerëve dhe të anëtarëve të personelit të KH Summer Camp.
4. Fëmijët duhet të sillen me respekt ndaj drejtuesve, trainerëve dhe anëtarëve të personelit të KH Summer Camp dhe njëri-tjetrit në çdo kohë.
5. Art Land Albania ka të drejtë që të largojë nga KH Summer Camp fëmijët, që nuk respektojnë rregullat e sjelljes në KH Summer Camp, si dhe nuk plotësojnë kushtet për një bashkëjetesë të shëndetshme dhe paqësore në KH Summer Camp, të cilat lidhet me shfaqjen e sjelljeve agresive dhe të padëshirueshme, të cilat përfshijnë goditjet fizike, gjuhën ofenduese, format e bullizmit, veprimet fyese dhe të pahijshme ndaj një fëmije tjetër, përdorimi i armëve të ftohta prerëse ose shpuese, përdorimi i alkoolit, i cigareve, apo i lëndëve narkotike.
6. Fëmija që është dëshmitar, ose përjeton sjellje agresive dhe të padëshirueshme në KH Summer Camp, duhet të raportojë menjëherë te drejtuesit, trainerët dhe te anëtarët e personelit të KH Summer Camp.
7. Në rastet kur fëmija shfaq shenja të stresit emocional ose ka vështirësi në adaptim, anëtarët e personelit të KH Summer Camp do të ofrojnë mbështetje emocionale përmes një mekanizmi të dedikuar.

8. Art Land Albania rezervon të drejtën që të japë për fëmijën masat disiplinore të mëposhtme :
 - (a) paralajmërim verbal;
 - (b) paralajmërim me shkrim dhe njoftim me shkrim drejtuar prindit/kujdestarit ligjor të fëmijës;
 - (c) në rast të përsëritjes së shkeljeve, fëmija mund të përjashtohet nga aktivitetet në KH Summer Camp për një periudhë të caktuar.
 - (d) në raste të rënda (dhunë, bullizëm i vazhdueshëm, përdorim i substancave të ndaluara), fëmija do të përjashtohet nga KH Summer Camp dhe prindi/kujdestari ligjor nuk do të marrë rimbursimin e shumës së paguar në bazë të kontratës të lidhur me Art Land Albania.
9. Art Land Albania do të krijojë vende të posaçme, në të cilat fëmija do të vendosë sendet personale të zakonshme, sendet personale me vlerë, të etiketuar me emrin e tij. Art Land Albania nuk është përgjegjëse për humbjen, vjedhjen dhe/ose dëmtimin e sendeve të personale të zakonshme, të sendeve personale me vlerë të fëmijës para, gjatë dhe pas përfundimit të periudhave kohore në KH Summer Camp. Sendet personale të zakonshme, sendet personale me vlerë të fëmijës të humbura dhe/ose të braktisura, të cilat gjenden, do të ruhen nga Art Land Albania dhe do t'i dorëzohen prindit/kujdestarit ligjor të fëmijës për kthim në bazë të kërkesës drejtuar Art Land Albania.
10. Art Land Albania do të informojnë prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës për çdo emergjencë ose situatë të pazakontë që ndodh me fëmijën, ose që ndodh në KH Summer Camp. Art Land Albania do të autorizojë një anëtar të personelit të KH Summer Camp, që do të jetë në dispozicion për të komunikuar me prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës dhe për të marrë masat e nevojshme në rast emergjencash.
11. Anëtarët e personelit të KH Summer Camp do të sigurojnë ndihmë të shpejtë dhe kujdes shëndetësor për fëmijët në rast nevojë. Çdo informacion i rëndësishëm në lidhje me shëndetin e fëmijëve duhet të raportohet dhe të dokumentohet në mënyrë të rregullt.
12. Art Land Albania do të krijojë kushte të përshtatshme sigurie për fëmijët, duke përfshirë ushqimin, akomodimin dhe çdo aspekt tjetër që mund të ndikojë në shëndetin dhe mirëqënien e tyre.
13. Prindi/kujdestari ligjor i fëmijës dhe fëmijët janë të inkurajuar të komunikojnë hapur dhe të shprehin për çdo shqetësim ose pyetje që kanë në lidhje me KH Summer Camp. Drejtuesit, trenerët dhe anëtarët e personelit të KH Summer Camp do të jenë në dispozicion për të ofruar këshillim dhe ndihmë për të gjitha pyetjet dhe shqetësimet që mund të lindin në KH Summer Camp.
14. Fëmijët duhet të respektojnë zonat e caktuara të KH Summer Camp dhe nuk duhet të shkelin në zona të ndaluara.
15. Fëmijët nuk duhet të dëmtojnë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme në të cilat organizohen dhe realizohen veprimtaritë argëtuese, edukurse, zhvilluese për fëmijët, që janë në pronësi të Art Land Albania, ose që janë marrë me qira nga Art Land Albania. Prindi/kujdestari ligjor i fëmijës është i detyruar që të dëmshpërblejë Art Land Albania për çdo dëmtim të tyre.
16. Fëmijët ndalohen rreptësisht që për asnjë arsye të nxjerrin nga dhomat objekte/sende jo personale si: çarçafë, batanie që janë marrë me qira nga Art Land Albania. Prindi/kujdestari ligjor i fëmijës është i detyruar që të dëmshpërblejë Art Land Albania për çdo dëmtim të tyre jashtë hapësirave të përcaktuara.
17. Për çdo mosmarrëveshje dhe/ose kërkesë, prindi/kujdestari ligjor i fëmijës duhet të kontaktojë ekskluzivisht personin përgjegjës të KH Summer Camp, i cili mund të arrihet përmes postës elektronike në adresën: info@summercamp.com ose në numrin e telefonit: +355 69 707 7400.
18. Fëmijët janë të detyruar që të jenë të veshur gjithmonë me uniformën përkatëse të KH Summer Camp, sipas udhëzimeve të anëtarëve të personelit të KH Summer Camp.
19. Gjatë kohës së pushimit apo gjumit fëmijët nuk duhet të prishin qetësinë e të tjerëve.
20. Fëmijët duhet të mbajnë higjienën e duhur personale dhe kolektive, duke përfshirë dushet e rregullta, larjen e dhëmbëve dhe larjen e duarve, dhe hapësirën personale.
21. Fëmijët duhet të kontribuojnë në mbrojtjen e natyrës dhe mbajtjen pastër të mjedisit në KH Summer Camp.
22. Ndalohet sjellja e ushqimeve në KH Summer Camp prej fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve ligjorë në rastet e vizitave të parashikuara nga personeli i KH Summer Camp.

Neni 7

PËRDORIMI I PAJISJEVE ELEKTRONIKE

1. Fëmijët nuk lejohet të marrin me vete në KH Summer Camp telefonat mobile, ose pajisje të tjera elektronike, duke përfshirë pajisje audio dhe video regjistruese, përveç aparateve me fotografi çasti (InstaX). Në rast konstatimi, anëtarët e personelit të KH Summer Camp do t'i vendosin në një vend të posaçëm për ruajtje, deri në përfundim të KH Summer Camp.
2. Në raste emergjente, fëmijët mund të kontaktojnë prindërit/ kujdestarët ligjorë në çdo kohë përmes drejtuesve të KH Summer Camp.

Neni 8

VIZITAT NË KH SUMMER CAMP DHE KOMUNIKIMI

1. Prindi/kujdestari ligjor i fëmijës nuk mund të vizitojë fëmijën gjatë qëndrimit në KH Summer Camp, përveç rasteve emergjente shëndetësore ose nëse fëmija shpreh nevojën për vizitë. Nevoja duhet të miratohet nga drejtuesit e KH Summer Camp në konsultim me prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës.
2. Gjatë gjithë qëndrimit të fëmijës në KH Summer Camp, prindi/kujdestari ligjor i fëmijës ka të drejtë të telefonojë drejtuesit e KH Summer Camp, për t'u informuar mbi fëmijën.
3. Për arsye logjistike prindi/kujdestari ligjor i fëmijës nuk ka të drejtë të kërkojë foto/video live të fëmijës nëpërmjet Whats App, përjashtuar rastin kur fëmija kërkon të flasë me të. I njëjti rregull vlen edhe për rrjetet sociale Instagram, Facebook që luajnë rol marketimi dhe jo komunikimi me prindin/kujdestarin ligjor të fëmijës.

Neni 9

TRANSPORTI

1. Art Land Albania i ofron prindit/kujdestarit ligjor të fëmijës kundrejt pagesës paketat e posaçme për transportin e fëmijës për në KH Summer Camp, si vijon:
 - (a) për transportin vajtje – ardhje;
 - (b) për transportin vetëm vajtje;
 - (c) për transportin vetëm ardhje.
2. Nëse prindi/kujdestari ligjor të fëmijës, nuk bie dakord që të paguajë ndonjëren prej paketave të posaçme për transportin e fëmijës për në KH Summer Camp të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, atëherë prindi/kujdestari ligjor i fëmijës merr pësipër detyrimin që të sigurojnë ofrojnë transportin, ose të mbulojë shpenzimet e transportit për Fëmijën për në KH Summer Camp dhe në kthim.
3. Vendi dhe orari i nisjes për në KH Summer Camp, si dhe orari i kthimit nga KH Summer Camp do të përcaktohet nga Art Land Albania dhe do t'i njoftohet me shkrim Prindit përmes postës elektronike (e-mail), si dhe përmes mesazheve të shkruara në telefoni mobil.

Neni 10

REKOMANDIME

1. Rekomandohet të mos krijohen grumbullime gjatë dorëzimit dhe grumbullimit të fëmijëve nga vendi i nisjes për në KH Summer Camp, për këtë arsye fëmijët duhet të shoqërohen vetëm nga dy familjarë.
2. Nuk është e rekomandueshme që të pajisni me para xhepi fëmijën në KH Summer Camp. Nëse vendosni që të pajisni fëmijën me para xhepi, i'u rekomandojmë t'i jepni me vete një shumë të kufizuar parash për shpenzime shtesë jashtë menisë së përcaktuar.
3. Njoftojmë se drejtuesit, trenerët dhe anëtarët e personelit të KH Summer Camp nuk mbajnë asnjë përgjegjësi në rast humbje apo shpërdorimi të parave të xhepit të fëmijëve.

Neni 11

RUAJTJA E AMBIENTEVE NË KH SUMMER CAMP

Ruajtja e ambienteve, si dhe e mjedisëve të brendshme të tyre në KH Summer Camp, kryhet përmes rojeve civile dhe përmes kamerave të sigurisë.

Neni 12

PAGESA E SHUMËS GJATË MUAJIT MARS 2025

1. Në rast se prindi/kujdestari ligjor i fëmijës kryen gjatë muajit mars 2025 regjistrimin dhe pagesën e shumës në përputhje me kontratën që lidh me Art Land Albania, atëherë prindi/kujdestari ligjor i fëmijës fiton të drejtën që të kryejë pagesën e shumës me tre këste pagese në vlera të barabarta, sipas mënyrës vijuese:
 - (a) kësti i parë në muajin Mars 2025;
 - (b) kësti i dytë në muajin Prill 2025;
 - (c) kësti i tretë në muajin Maj 2025.
2. Në rast se prindi/kujdestari ligjor i fëmijës paguan vetëm këstin e parë dhe zgjidh kontratën e lidhur me Art Land Albania sipas kushteve të kontratës, Art Land Albania nuk do të kryejë rimbursimin e këstit të parë.

Neni 13

HYRJA NË FUQI

1. Rregullorja hyn në fuqi me miratimin e saj nga Art Land Albania.
2. Rregullorja ndryshohet me vendim të Art Land Albania.
3. Asnjë prej dispozitave të kësaj rregulloreje nuk mund të interpretohet në mënyrë të veçuar nga njëra – tjetra.